

ANALIZË DHE KOMENTE  
NË PROJEKTLIGJIN PËR

# ENERGJINË ELEKTRIKE





# ANALIZË DHE KOMENTE NË PROJEKTLIGJIN PËR ENERGJINË ELEKTRIKE

Mars, 2024

**Autorë:** Dardan Abazi  
Liron Gjocaj

**Programi:** Zhvillim i Qëndrueshëm

**Publikuar:** Mars, 2024



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

#### **Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



**Rockefeller  
Brothers Fund**  
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

---

## **Përmbajtja**

Hyrje dhe Komente të Përgjithshme.....	1
Komentet dhe rekomandimet specifike të INDEP .....	2
Përfundime dhe Rekomandime .....	9

## Hyrje dhe Komente të Përgjithshme

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), ka analizuar Projektligjin për Energjinë Elektrike, i hartuar dhe publikuar për konsultim nga ana e Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Kosovës. Kjo analizë dhe këto komente janë rezultat i përkushtimit që Instituti INDEP ka për fuqizim të sektorit të energjisë dhe për rritje të dinamikës së tranzicionit të drejtë energjetik. Analiza e hartuar në kuadër të programit të INDEP për zhvillim të qëndrueshëm, synon që të identifikoj fushat ku projektligji ka nevojë për përmirësim dhe të ofroj një qasje konstruktive për përmirësimin e tij.

Marrë në tërësi, INDEP konsideron që Projektligji për Energi Elektrike i plotëson kërkesat e direktivave evropiane për pakon e re të legjislacionit në fushën e energjisë dhe është një bazë e mirë për rregullimin ligjor të sektorit për vitet e ardhshme.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) thekson rëndësinë e angazhimit dhe konsultimit të gjerë me të gjithë palët e interesit në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të Projektligjit për Energjinë. Në dokumentin e konsultimit, ne i bëjmë thirrje Qeverisë që të përfshij qëndrimet e ZRRE-së, KOSTT-it dhe akterëve të tjerë në mënyrë që publiku i gjerë të njihet me pikëpamjet e këtyre palëve. Përmes një qasjeje të tillë të hapur dhe gjithëpërfshirëse, INDEP beson se mund të kontribuohet në zhvillimin e një kuadri ligjor që nxit inovacionin, përmirëson eficiencën e energjisë, mbështet tranzicionin drejt burimeve të rinovueshme të energjisë, dhe përmbush nevojat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, veçanërisht ato të konsumatorëve në nevojë.

Kosova ka adoptuar një strategji të re të energjisë që vendos shtetin në rrugën e dekarbonizimit. Për këtë, rëndësia e Projektligjit për Energjinë Elektrike bëhet edhe më thelbësore. Në masë të madhe, tranzicioni energjetik është në korrelacion të drejtë me elektrifikimin.

Ky ligj dhe transpozimi i pakos së re të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë është një hap shumë i rëndësishëm drejt një ekonomie më të gjelbër dhe më të qëndrueshme, dhe një pjesë shumë e rëndësishme e rrugëtimit të Kosovës drejt dekarbonizimit dhe përafrimit me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane në fushën e energjisë. Prandaj, mundësia për ta bërë këtë Ligj më të mirë e më të zbatueshëm, nuk duhet humbur!

Në vazhdim, INDEP ka listuar komentet pas analizës nen-për-nen të Projektligjit. Në pjesën në vazhdim, do të paraqesim vërejtjet dhe rekomandimet specifike të INDEP në lidhje me këtë Projektligj.

## **Komentet dhe rekomandimet specifike të INDEP**

### **Komenti 1. Neni 4 – Aktivitetet e sektorit të energjisë**

INDEP propozon që të shtohet Paragrafi 1.9. menaxhimi i energjisë, si një nga aktivitetet e energjisë që janë në kuptim të ligjit në fjalë.

Shtimi i Paragrafit 1.9 në Nenin 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, që përfshin menaxhimin e energjisë si një nga aktivitetet kyçe të energjisë të njohura me ligj, është një hap i rëndësishëm për të rritur rëndësinë e një qasjeje të integruar dhe të mençur ndaj përdorimit dhe furnizimit me energji. Me këtë njihet zyrtarisht menaxhimi i energjisë si një segment vital i ekosistemit energjetik, dhe promovohet përmirësimi i efikasitetit energjetik në të gjitha nivelet. Duke e përfshirë menaxhimin e energjisë si një aktivitet ligjor, ligji inkurajon investimet në teknologjitë dhe metodologjitë e reja që ndihmojnë në monitorimin, kontrollin dhe optimizimin e konsumit të energjisë, duke kontribuar në reduktimin e kostove për konsumatorët dhe në uljen e ndikimit mjedisor të aktiviteteve njerëzore. Kjo qasje është në përputhje me angazhimet ndërkombëtare për qëndrueshmëri duke u bërë një element kyç në tranzicionin e vendit drejt një ekonomie me intensitet të ulët të karbonit.

### **Komenti 2. Neni 7 - Rezervat e lëndës djegëse për prodhim të energjisë elektrike**

INDEP propozon heqjen e tërësishme të këtij neni. Kjo, bazuar në faktin që Kosova ka rezerva të bollshme të lëndës kryesore fosile (linjtit) për për të siguruar prodhim të vazhdueshëm dhe të besueshëm të energjisë elektrike. Rezervat e Kosovës në linjit, tejkalojnë për qindra vite, sasinë e kërkuar të linjtit deri në dekarbonizimin e sektorit. Për më tepër, Neni 7 nuk ka përcaktuar nivelin dhe kohëzgjatjen e rezervave të lëndës djegëse fosile, që duhet ta mbajnë prodhuesit e energjisë elektrike dhe i ka lënë diskrecionin Ministrisë për këtë vendim. Neni, kështu, krijon edhe kosto të pa justifikueshme për kompensim të prodhuesit, dhe krijon potencial për keqpërdorim të kësaj dispozite për të vendosur ndihmë shtetërore për burime ndotëse.

### **Komenti 3. Neni 9 – Operatori i Sistemit të Transmetimit**

INDEP kërkon që në paragrafin 3 të nenit 9, të drejtat e aksionarit të i ushtroj Qeveria e Republikës së Kosovës dhe jo specifikisht Ministria e Financave. Për INDEP, largimi i kompetencës së ushtrimit të autoritetit të aksionarit nga Kuvendi i Kosovës në Qeveri është pozitiv dhe e mbështesim sepse më në fund zbaton dispozitat e nenit 160 të Kushtetutës së Kosovës dhe faktit që Qeveria e Kosovës është pushteti që ushtron përgjegjësinë e aksionarit ndaj ndërmarrjeve publike qëndrore. Megjithatë, Ministria e Financave nuk është autoriteti që e ka nën përgjegjësinë e vet ekzekutive dhe fushëveprimtarinë e vet sektorin e energjisë.

Ndonëse e kuptojmë që mund të ketë shqetësime sa i takon konfliktit të interesit që edhe Operatori i Sistemit të Transmetimit edhe prodhuesi kryesor (KEK) të kenë një aksionar të vetëm, për INDEP, kjo është pasojë e mos-diversifikimit me kohë të burimeve të prodhimit dhe eventualisht edhe mos-privatizimit të tyre. Sidoqoftë, kjo nuk mund të arsyetoj që organe që s'mund të ushtrojnë kompetencën e ushtrimit të të drejtave të aksionarit ta bëjnë këtë!

Gjithashtu paragrafi 2 i nenit 43 të këtij Projektligji krijon një masë mbrojtëse për ruajtjen e pavarësisë së Operatorit të Tregut përmes dispozitës:

“Për të garantuar pavarësinë e Operatorit të Tregut, personat përgjegjës për menaxhimin e tyre nuk mund të marrin pjesë në asnjë strukturë apo proces vendimmarrës të Ministrisë, Rregullatorit apo ndonjë ndërmarrje të energjisë përgjegjëse për prodhimin, furnizimin, shpërndarjen apo mihjet nga qymyri apo furnizime të tjera me lëndë djegëse.”

Ky standard besojmë është i mjaftueshëm për të siguruar që aksionari të mos krijoj situatë të konfliktit apo cenimit të pavarësisë së Operatorit të Transmetimit dhe mund të përdoret edhe tek neni 9.

#### **Komenti 4. Neni 16 - Pronësia dhe përdorimi i stabilimenteve të ruajtjes së energjisë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit**

INDEP konsideron që paragrafi 1 dhe 2 i Nenit 16 janë në kontradiktë me njëri-tjetrin. Për këtë, propozojmë riformulim dhe shkrirje të dy paragrafëve në një paragraf. Përmbajtja që INDEP propozon është kjo:

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk mund të ketë në pronësi, zhvillojë, menaxhojë apo operojë me stabilimente të ruajtjes së energjisë përveç nëse është komponent i rrjetit tërësisht të integruar dhe Rregullatori ka dhënë aprovimin e tyre.

#### **Komenti 5. Neni 20 - Obligimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Konfidencialitet të të dhënave**

INDEP propozon që pjesë e këtij neni të jetë edhe Paragrafi 5, me përmbajtje si më poshtë:

“Informacionet që nuk janë konfidenciale, të lejohen që të kenë qasje të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe publikun.”

Kjo ndikon në rritjen e transparencës, në zvogëlimin e keqinterpretimeve, në zvogëlimin e keqpërdorimeve dhe benefiteve të tjera. Gjithashtu, qasja në informacionet që nuk janë konfidenciale kontribuon në informimin e drejtë të publikut, gjë që shpesh herë si pasojë e mos lejimit të qasjes në këto informacione, krijon lajme të rrejshme dhe keqinterpretime të ndryshme.

#### **Komenti 6. Neni 24 – Adekuacia e burimeve**

INDEP propozon që në paragrafin 3 të neni 24 në vend të Ministrisë përgjegjëse, autoritet përgjegjës të jetë Rregullatori. Përmbajtja e paragrafit 3 të jetë si në vazhdim:

1. Kur vlerësimi evropian i adekuacisë së burimeve ose vlerësimi kombëtar i adekuacisë së burimeve vëren ndonjë lëshim lidhur me adekuacinë e tyre (burimeve), Rregullatori identifikon çdo ndryshim rregullativ ose joperformancë të tregut që mund ta ketë shkaktuar ose të ketë kontribuar në këtë lëshim, si dhe obligon Operatorin e Sistemit të



Transmetimit të energjisë elektrike të përgatisë një plan zbatimi me afat kohor për miratimin e masave për të eliminuar çdo lëshim rregullativ, që identifikohet, ose çdo joperformancë të tregut, i cili pas miratimit të Rregullatorit publikohet në uebfaqen e TSO-së.

Shprehja të përshtatet në të gjithë përmbajtjen e nenit.

Ky element përfshin një dispozitë rregullatorë që nuk duhet t'i takoj Ministrisë por duhet të ruhet brenda kompetencave të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Konsiderojmë që Ministria nuk mund të marrë kompetenca rregullatore.

## **Komenti 7. Neni 40 – Tregu i Energjisë Elektrike**

**INDEP kërkon sqarim sa i takon paragrafit 3 të nenit 40 i cilë thekson që:**

Tregu dypalësh i energjisë elektrike është një treg ku blerja dhe shitja e energjisë elektrike kryhet drejtpërdrejt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike nëpërmjet një kontrate dypalëshe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike.

Kërkesa e INDEP është që të sqarohet nëse ky paragraf e mbulon marrëveshjen e BSA (Bulk Supply Agreement) në mes të KESCO dhe KEK si pjesë e privatizimit të distribucionit. Në nenin 67 të këtij Projektligji thuhet që:

Të gjithë furnizuesit blejnë energji elektrike për furnizimin e konsumatorëve të tyre fundorë në tregun dypalësh (bilateral) dhe në tregun e organizuar me çmime të parregulluara. Furnizuesit janë të lirë të përcaktojnë çmimin e furnizimit me energji elektrike.

Ne duam të sqarojmë nëse me këtë Ligj, ne përfundimisht po e largojmë KEK-un nga një obligim kontraktual që po e pengon liberalizimin e tregut apo po i krijojmë bazë ligjore furnizuesit që këtë marrëveshje ta trajtoj në kuadër të paragrafit 3 të nenit 40 të këtij Projektligji dhe kështu po ia krijojmë bazën ligjore. Ligji duhet gjithashtu të përcaktoj kohëzgjatjen e marrëveshjeve dy-palëshe për të mbrojtur tregun e lirë nga kontratat që i pamundësojnë operatorëve të tjerë të furnizimit hyrjen de-facto në treg.

## **Komenti 8 – Neni 56 – Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

Nënparagrafi 16, i paragrafit 2 të nenit 56 i jep autoritet Operatorit të Shpërndarjes të “krijojë dhe mbajë regjistër të konsumatorëve në nevojë;”. INDEP konsideron që kjo pikë duhet të hiqet. Në bazë të Projektligjit për Energjinë, është Ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale që i përcakton kriteret për marrjen e statusit të konsumatorit në nevojë. Gjithashtu, një regjistër të tillë duhet t'a mbaj Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale dhe kjo të mos jetë asesi punë e operatorit të sistemit të shpërndarjes. Mbështetja ndaj kategorive të ndjeshme dhe në nevojë duhet të organizohet përmes skemave, programeve dhe mekanizmave të mbrojtjes sociale dhe jo përmes ndërmarrjeve të energjisë në një treg që synon hapjen, konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit.

## **Komenti 9 – Neni 56 – Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

INDEP propozon që pas nënparagrafit 2.28 të Nenit 56, të shtohet paragrafi 2.29 me këtë përmbajtje:

2.29 Vë në dispozicion të publikut harta të detajuara të kapaciteteve teknike për konsumatorët dhe investimet e mundshme për të gjithë nivelet e investimit në energjinë e ripërtrishme në të gjitha rajonet dhe lokalitetet e Kosovës.

Të njëjtën dispozitë INDEP e ka propozuar edhe në Ligjin për Promovimin e Burimeve të Ripërtrishme të Energjisë. Dispozita mbështetet nga direktiva, raporte kyçe dhe iniciativa tjera të Bashkimit Evropian. Angazhimi i Bashkimit Evropian ndaj Marrëveshjes së Gjellbër dhe përqendrimi i shtuar në energjinë e ripërtrishme si një element vendimtar në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë përputhet me frymën e nenit 9a. Agjenda e Gjellbër për Ballkanin perëndimor bënë thirrje për fuqizim të investimeve në burime të ripërtrishme të energjisë.

Plani REPowerEU thekson më tej nevojën për energji të erës dhe diellore dhe rritjen e shkallës së përdorimit të energjisë së rinovueshme, si dhe zgjerimin e kapacitetit për të mbështetur prodhimin më të lartë të karburanteve të ripërtrishme. Ky plan, i cili synon pavarësinë e BE-së nga karburantet fosile përpara vitit 2030, nënvizon domosdoshmërinë që shtetet anëtare dhe anëtarët aspirantë si Kosova të zhvillojnë korniza të fuqishme dhe transparente për promovimin e energjisë së ripërtrishme.

Për më tepër, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën pranon progresin e bërë në sektorin e energjisë, duke përfshirë miratimin e një strategjie energjetike për 2022-2031. Megjithatë, ai vë në dukje gjithashtu mungesën e konsensusit për shumë çështje, duke përfshirë politikën energjetike, duke sugjeruar nevojën për informacion më të detajuar dhe transparent për të nxitur vendimmarrjen e informuar.

## **Komenti 10. Neni 85 – Komunitetet qytetare të energjisë**

**INDEP propozon shtimin e paragrafit 18 të nenit 85 me këtë përmbajtje:**

18. Për të nxitur zhvillimin e komuniteteve energjetike të qytetarëve, në afat prej tre (3) muajve nga miratimi i këtij Ligji, Rregullatori shqyrëton dhe heqë të gjitha barrierat e pajustificuara rregullatore dhe administrative. Kjo përfshin thjeshtimin e procesit për lidhjen e projekteve të energjisë së komunitetit me rrjetin dhe vendosjen e një kuadri rregullator mbështetës që njeh nevojat dhe kapacitetet specifike të komuniteteve energjetike të qytetarëve.

Rekomandimi i INDEP është në përputhje me kërkesat e Udhëzuesit të Politikave të Komunitetit të Energjisë për konceptin e komuniteteve të energjisë, i publikuar me 12 mars 2024<sup>1</sup>. Dokumenti thekson që është thelbësore për zhvillimin e komuniteteve të energjisë që të identifikohen dhe eliminohen pengesat dhe kufizimet e pajustificuara. Kjo përfshin thjeshtimin e procesit për lidhjen

---

<sup>1</sup> I qasshëm në [Secretariat publishes policy guidelines on the concepts of energy communities - Energy Community Homepage \(energy-community.org\)](https://energy-community.org/)

në rrjet të projekteve të energjisë në komunitet dhe krijimin e një kuadri rregullator që është mbështetës dhe që njih nevojat dhe kapacitetet specifike të komuniteteve energjetike të qytetarëve. Si Direktiva e Tregut të Brendshëm për Energjinë Elektrike (BE) 2019/944 (IMED) ashtu edhe Direktiva për Energjinë e Rinovueshme (BE) 2018/2001 (RED II) kërkojnë që të miratohen korniza mundësuese për të nxitur dhe lehtësuar zhvillimin dhe funksionimin e BRE-ve dhe KQE-ve dhe për të hequr barrierat administrative dhe rregullatorë.

## **Komenti 11. Neni 85 – Komunitetet qytetare të energjisë**

### **INDEP propozon shtimin e paragrafit 19 të nenit 85 me këtë përmbajtje**

19. Komunitetet qytetare të energjisë kanë të drejtë për qasje në skema mbështetëse të dizajnuara posaçërisht për të inkurajuar projektet e energjisë së rinovueshme brenda komuniteteve. Këto skema mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, grante, stimuj financiarë dhe qasje preferenciale në financim. Masat mbështetëse duhet të marrin parasysh përfitimet sociale, mjedisore dhe ekonomike të ofruara nga këto komunitete, jo vetëm kapacitetin e tyre për prodhimin e energjisë.

Ky amendament i propozuar është në përputhje të plotë me dokumentin e Sekretariatit të Energjisë. Konkretisht, dokumenti thekson se mbështetja për energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme duhet të jepet përmes procedurave të hapura dhe konkurruese. Megjithatë, ai gjithashtu pranon se komunitetet e energjisë së rinovueshme (BRE) mund të përballen me sfida në përmbushjen e kërkesave për të marrë pjesë në këto procedura për shkak të kufizimeve në burimet financiare dhe njerëzore. Prandaj, specifikat e BRE-ve duhet të merren parasysh gjatë hartimit të skemave mbështetëse për t'u mundësuar atyre të konkurrojnë për mbështetje financiare mundësi të barabarta me lojtarët më të mëdhenj. Dokumenti i EC gjithashtu thekson që Palët Kontraktuese mund të marrin në konsideratë lloje të ndryshme stimujsh financiarë dhe jo-financiarë për të promovuar iniciativat qytetare, duke përfshirë skemat mbështetëse që mund të përfshijnë grante, stimuj financiarë dhe akses preferencial në financim.

Masat e tilla mbështetëse këshillohen të marrin në konsideratë përfitimet sociale, mjedisore dhe ekonomike të ofruara nga komunitetet energjetike, jo vetëm kapacitetin e tyre të prodhimit të energjisë. Dokumenti rekomandon gjithashtu hartimin e kornizave mundësuese që përfshijnë skema mbështetëse që nxisin zhvillimin e këtyre komuniteteve. Kjo përfshin ofrimin e avantazheve financiare, procedurat më të shkurtra dhe lidhjet prioritare të rrjetit për komunitetet energjetike, të cilat përputhen drejtpërdrejt me thelbin e amendamentit të propozuar. Kjo qasje jo vetëm që lehtëson rritjen e projekteve të energjisë së rinovueshme brenda komuniteteve, por gjithashtu njih dhe mbështet vlerën e shumëanshme që këto komunitete sjellin për tranzicionin e energjisë.

## **Komenti 11. Neni 85 – Komunitetet qytetare të energjisë**

### **INDEP propozon shtimin e paragrafit 20 të nenit 85 me këtë përmbajtje**

20. Ministria përgjegjëse për energji, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mirëqenie sociale, brenda gjashtë (6) muajve nga miratimi i këtij Ligji hartojnë një plan të veçantë për të lehtësuar pjesëmarrjen e familjeve me të ardhura të ulëta dhe

të cenueshme në komunitetet qytetare të energjisë. Kjo përfshin adresimin e barrierave të mundshme financiare ndaj pjesëmarrjes dhe sigurimin që komunitetet energjetike të kontribuojnë në zbutjen e varfërisë energjetike.

Amendamenti i propozuar është në përputhje të plotë me udhëzimet e Komunitetit të Energjisë i cili thekson sfidën e adresimit të varfërisë energjetike në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe thekson potencialin e komuniteteve të energjisë për të kontribuar në zbutjen e varfërisë energjetike. Kjo përfshin promovimin e energjisë së rinovueshme, përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe krijimin e mundësive ekonomike lokale të cilat mund të ulin kolektivisht kostot e energjisë për familjet me të ardhura të ulëta dhe të cenueshme.

Sekretariati i energjisë gjithashtu nënvizon rëndësinë që komunitetet energjetike të jenë gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjitha segmentet e shoqërisë, duke përfshirë familjet me të ardhura të ulëta dhe të cenueshme. Kjo përfshin nevojën për politika dhe masa që adresojnë në mënyrë specifike barrierat me të cilat përballen këto grupe në pjesëmarrjen në komunitetet energjetike, si barrierat financiare, mungesa e informacionit ose qasja në teknologji. Dokumenti ofron rekomandime për autoritetet kombëtare dhe lokale për të zhvilluar iniciativa që ofrojnë akses në teknologji dhe burime, veçanërisht për grupet vulnerabël, dhe për të hartuar politika që ofrojnë stimuj ose grante për të inkurajuar përfshirjen e familjeve të varfra me energji në komunitetet energjetike. Kjo përfshin ndihmën e drejtpërdrejtë financiare ose subvencione për të kompensuar kostot fillestare që lidhen me bashkimin me komunitetet e energjisë.

## **Komenti 12. Neni 93 – Siguria e Furnizimit**

Pas nënparagrafit 2.9 të nenit 93, INDEP propozon nënparagrafin 2.10 me këtë përmbajtje:

2.10. Promovimin dhe mbështetjen e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme dhe masave të efikasitetit të energjisë për të ulur varësinë nga burimet e jashtme dhe për të përforcuar sigurinë e furnizimit me energji. Kjo përfshin:

2.10.1. Inkurajimin e zhvillimit dhe integritit të projekteve të energjisë së rinovueshme të udhëhequra nga komunitetet dhe individët, si një mënyrë për të diversifikuar burimet e energjisë dhe për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në sistemin energjetik.

2.10.2. Vendosjen e politikave dhe masave stimuluese për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat rezidenciale, tregtare dhe industriale, si dhe në infrastrukturën e transportit, për të ulur kërkesën totale për energji dhe për të kontribuar në stabilitetin e sistemit energjetik.

2.10.3. Zbatimin e programeve të fokusuara në nxitjen e përdorimit të teknologjive të energjisë së rinovueshme dhe masave të efikasitetit të energjisë, veçanërisht në zonat me të ardhura të ulëta dhe të cenueshme, për të adresuar varfërinë energjetike dhe për të promovuar një tranzicion të drejtë dhe gjithëpërfshirës energjetik.

2.10.4. Forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar në zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme dhe në përmirësimin e efikasitetit të energjisë së rinovueshme dhe në përmirësimin e efikasitetit të energjisë së rinovueshme.

energjisë, për të ndërtuar një rrjet më të qëndrueshëm dhe divers të furnizimit me energji.

INDEP konsideron që vendosja e një dispozite të tillë shprehë rëndësinë e diversifikimit të burimeve të energjisë përmes rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme. Kjo redukton varësinë nga karburantet ndotëse dhe ato të importuara dhe rrit sigurinë kombëtare të energjisë. Burimet e rinovueshme të energjisë, duke qenë të disponueshme në nivel lokal, zbusin rreziqet që lidhen me tensionet gjeopolitike, ndërprerjet e furnizimit dhe luhatjet e çmimeve të karburanteve fosile.

Përfshirja e komuniteteve qytetare të energjisë në sistemin energjetik fuqizon popullsinë lokale, nxit kohezionin social dhe siguron një tranzicion energjetik më demokratik. Komunitetet që marrin pjesë aktive në prodhimin, konsumimin dhe menaxhimin e energjisë së rinovueshme kontribuojnë në një sistem energjie më elastik dhe fleksibël.

Duke u fokusuar në energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, veçanërisht në zonat me të ardhura të ulëta dhe vulnerabël, kjo shtesë e propozuar synon të përfshij varfërinë energjetike.

Kjo shtesë e propozuar përputhet me politikat ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian për energjinë dhe klimën, të cilat synojnë tranzicionin në një sistem energjie të qëndrueshëm, të sigurt dhe konkurrues. Inkurajimi i përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe efijencës së energjisë është thelbësor për këto politika, duke reflektuar angazhimin e Kosovës për të përmbushur objektivat e Agjendës së Gjelbër dhe për të arritur pavarësinë energjetike.

## Përfundime dhe Rekomandime

Procesi i konsultimit për legjislacionin në fushën e energjisë paraqet një mundësi kyçe për të inkorporuar perspektiva dhe ekspertizë të ndryshme për të përmirësuar dhe forcuar kornizën ligjore që rregullon sektorin energjetik të Kosovës. Është evidente se përfshirja e komenteve dhe vërejtjeve nga Zyra e Rregullatorit dhe institucionet e tjera relevante në Dokumentin e Konsultimit rrit transparencën, duke siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe praktike. Prandaj rekomandojmë që Dokumenti i Konsultimit të listojë në mënyrë eksplicite të gjitha komentet dhe sugjerimet e dorëzuara nga Zyra e Rregullatorit dhe institucionet tjera të përfshira në konsultimet e grupit punues. Kjo qasje do të rrisë transparencën, do të lehtësojë vendimmarrjen e informuar dhe do të sigurojë që të gjitha njohuritë përkatëse të merren parasysh nga palët që duan të komentojnë në procesin e konsultimit publik.

Komentet e ofruara nga INDEP mbi nenet e ndryshme të Ligjit të propozuar për Energjinë Elektrike dëshmojnë edhe njëherë qasjen gjithëpërfshirëse të Institutit drejt përmirësimit të kornizës rregullative për energjinë në Kosovë. Çdo koment, duke filluar nga përfshirja e menaxhimit të energjisë si një aktivitet i njohur brenda sektorit të energjisë deri te heqja e artikujve të veçantë që konsiderohen të panevojshëm për shkak të rezervave të bollshme të linjtit në Kosovë, pasqyron analizën e nevojave që INDEP e ka bërë mbi sfidat dhe nevojat e sektorit energjetik të vendit.

Rekomandimi i INDEP për të hequr tërësisht nenin 7, bazuar në rezervat e konsiderueshme të linjtit të Kosovës, është rezultat i një qasjeje pragmatike ndaj prodhimit të energjisë, duke evituar gjithashtu krijimin e kostove të pajustificueshme dhe potencialin për keqpërdorim rregullator.

Lidhur me nenet 16 dhe 20, INDEP bën thirrje për qartësi dhe konsistencë në dispozitat rregullatore që lidhen me funksionimin dhe pronësinë e objekteve të ruajtjes së energjisë dhe konfidencialitetin e të dhënave nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. Këto komente nënvizojnë nevojën për korniza rregullatore që mbështesin pavarësinë e operatorëve të energjisë dhe transparencën në tregun e energjisë.

Shqetësimi i INDEP në lidhje me nenin 56, veçanërisht propozimi për të eliminuar përgjegjësinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për mbajtjen e një regjistri të konsumatorëve në nevojë, është gjithashtu pjesë e thirrjeve edhe të mëparshme të Institutit që skemat mbështetëse të menaxhohen jashtë sektorit të energjisë për të garantuar drejtësi, efikasitet dhe ruajtje të konkurrencës në treg.

Qeveria duhet të plotësoj nenin 85, në mënyrë që të mundësohet heqja e barrierave rregullatore dhe ofrimi i skemave mbështetëse për të lehtësuar projektet e energjisë së rinovueshme dhe adresimin e varfërisë energjetike.

Si përfundim, komentet dhe rekomandimet e INDEP-it kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e këtij projektligji. Në këtë frymë, i bëjmë thirrje grupit punues brenda Ministrisë që të marrë në konsideratë dhe të pranoj plotësisht inkorporimin e tyre në draftin final.



**Ky punim u botua me mbështetjen e Fondit të vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti përfshirë opinionet e shprehura, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të INDEP-it, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo bordit.**

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

